



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MEMALIAJ
KOORDINATOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT ME PUBLIKUN

Nr 132 Prot

Memaliaj më, 16.01. 2026

NJOFTIM
PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN
“PËR PLANIN SOCIAL VENDOR 2026-2029 DHE PLANIN VENDOR TË VEPRIMIT
PËR BARAZINË GJINORE 2026-2029”.

Të nderuar qytetarë të Bashkisë Memaliaj,

Mbështetur në ligjin Nr.146/2014 “Për njoftim dhe konsultim publik” pika 1 dhe 2 neni 5, ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në kuadër të sigurimit të transparencës dhe angazhimit të qytetarëve për të adresuar nevojat e tyre;

Bashkia Memaliaj nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Sociale ka përgatitur Planin Social Vendor 2026-2029 dhe Planin Vendor të Veprimit Barazisë Gjinore, ka hartuar dy dokumenta strategjik që synojnë të adresojnë dhe përmirësojnë çështjet sociale dhe çështjet e barazisë gjinore në komunitetin tonë.

Planet përmbajnë një analizë të situatës aktuale, identifikimin e nevojave kryesore dhe një set masash konkrete për të mbështetur grupet më të cënueshme të shoqërisë.

Për të siguruar që këto dy plane të reflektojnë nevojat dhe shqetësimet tuaja, po bëjmë ndarjen e tyre për konsultim publik si një mundësi e shkëlqyer për të ndarë mendimet, sygjerimet dhe propozimet tuaja duke kontribuar drejtpërdrejtë në krijimin e planeve që shërbejnë për interesat e të gjithë qytetarëve.

Ju inkurajojmë të merrni pjesë aktivisht në këtë proces dhe të bëheni pjesë e zgjidhjeve për një komunitet më të fortë dhe solidar.

- **Konsutimi Publik do të zhvillohet ditën e hënë, më datë 19.01.2026 ora 13:00 në sallën e këshillit bashkiak, në katin e parë.**

Janë të lutur të marrin pjesë të gjithë qytetarët, deputetë, anëtarë të këshillit bashkiak, kryepelq të fshatrave, anëtarë të Këshillit Vendor të Rinisë, përfaqësues të institucioneve arsimore, biznese,

OJF, përfaqësues të grupeve të interes dhe çdo të interesuar të bëhen pjesë e dëgjësave publike për të siguruar një proces transparent në vendimarrje.

KRYETARI
Albert Malaj

NË MUNGESË DHE ME POROSI

N/KRYETAR

Florian Çela

